FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

KIDAMOL

Pezulli orale – 160 mg / 5 ml
(Paracetamol)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për fëmijën tuaj. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Kidamol dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Kidamol
3. Si ta merrni Kidamol
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Kidamol
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË KIDAMOL DHE PËRSE PËRDORET

Kidamol përmban lëndën vepruese paracetamol, i cili është një derivat i para-aminofenolit. Ai ka veti analgjezike dhe antipiretike.
Kidamol - pezulli orale 160 mg / 5 ml indikohet në:

- lehtësimin e përkohshëm të dhimbjes së lehtë në të moderuar përfshirë: dhimbjen e dhëmbëve, dhimbjen e kokës, ndrydhjet dhe tendosjet e lehta muskulore;
- uljen e temperaturës, përfshirë temperaturën e lartë të shkaktuar nga vaksinat, ftohja dhe gripi.

2. PËRPARA SE TË MERRNI KIDAMOL

Kidamol kundërindikohet:

- në mbindjeshmëri ndaj paracetamolit ose ndaj përbërësve të tjerë të pezullisë orale;
- nëse jeni duke i përdorur fëmijës një bar tjetër që përmban paracetamol;
- në dëmtim të rëndë të funksionit të mëlçisë ose veshkave;
- në fëmijë nën 2 vjeç.

Tregoni kujdes të veçantë me Kidamol

Pyesni mjekun tuaj përpara se t'i jepni fëmijës Kidamol në qoftë se ka:

- pamjaftueshmëri të glukozë - 6 - fosfatdehidrogjenazës;
- dëmtim të funksionit të mëlçisë dhe të veshkave.

Flisni me mjekun tuaj në qoftë se simptomat zgjasin më shumë se 5 ditë, temperatura zgjat më shumë se 3 ditë, ose në qoftë se fëmija juaj shfaq reaksione alergjike si: fishkëllimë gjatë frymëmarrjes, rash ose kruarje.

Marrja e barnave të tjera

Kidamol nuk duhet të përdoret me barna të tjera që përmbajnë paracetamol. Këshillohuni me mjekun përpara përdorimit të Kidamol nëse fëmija merr produkte të tjera, si: produkte natyrale, salicilate, barna të tjera për trajtimin e dhimbjes dhe temperaturës, varfarinë, barbiturate, hidantoina, izoniazid, karbamazepinë, rifampicinë, sulfinpirazon, karbon aktiv, busulfan intravenoz, kolestiraminë, metoklopramid, zidovudinë, kloramfenikol.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Kidamol

Kidamol – pezulli orale përmban:

- afërsisht 875 mg sorbitol në 5 ml pezulli; sorbitoli është një burim i fruktozës; nëse ju është thënë nga mjeku që fëmija juaj ka intolerancë nga disa sheqerna, ose nëse është diagnostikuar me intolerancë të trashëguar ndaj fruktozës, një çrregullim i rrallë gjenetik ku personi nuk mund ta metabolizojë fruktozën, kontaktoni mjekun përpara se t'ja jepni fëmijës këtë bar; sorbitoli mund të shkaktojë diskomfort gastrointestinal dhe efekt të lehtë laksativ;
- 250 mg propilenglikol në 5 ml pezulli; nëse fëmija juaj është më pak se 5 vjeç, flisni me mjekun ose farmacistin përpara se t'i jepni këtë bar, veçanërisht nëse njëkohësisht jeni duke i dhënë barna të tjera që përmbajnë propilenglikol ose alkool; nëse lind nevoja që ky bar të përdoret nga një e rritur shtatzënë ose që ushqen me gji, bari nuk duhet të merret pa rekomandimin e mjekut; mjeku mund të bëjë kontrolle shtesë ndërkohë që e merrni barin; nëse fëmija juaj (ose ju) vuani nga sëmundje të mëlçisë ose veshkave, mos e merrni këtë bar pa rekomandimin e mjekut; mjeku mund të bëjë kontrolle shtesë ndërkohë që e merrni barin;
- metilhidroksibenzoat dhe propilhidroksibenzoat, që mund të shkaktojnë reaksione alergjike (ndoshta të vonuara).

3. SI TA MERRNI KIDAMOL

Gjithmonë merreni Kidamol sipas këshillës së mjekut ose farmacistit. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj. Në qoftë se ndjeni që efektet e Kidamol janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Tundeni mirë shishen përpara përdorimit.
Kidamol nuk duhet të përdoret në fëmijë nën 2 vjeç.

DOZIMI	
Mosha (Pesha):	**Doza unike**
2 - 3 vjeç (11 - 15.9 kg)	5 ml
4 - 5 vjeç (16 - 21.9 kg)	7.5 ml
6 - 8 vjeç (22 - 26.9 kg)	10 ml
9 - 10 vjeç (27 - 31.9 kg)	12.5 ml
11 vjeç (32 - 43.9 kg)	15 ml
Doza unike mund të përsëritet çdo 4 - 6 orë sipas nevojës. Kidamol nuk duhet të jepet më shumë se 4 herë në ditë. Ky bar nuk duhet të jepet për më shumë se 3 ditë rresht pa këshillë mjekësore.	

Në qoftë se fëmija juaj ka marrë më shumë Kidamol

Në qoftë se fëmija juaj ka marrë më shumë Kidamol se sasia që duhet të merrte, edhe nëse nuk shfaq simptoma shqetësuese, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Mbidoza mund të shkaktojë dëmtim të rëndë, deri fatal të mëlçisë.
Simptomat e mbidozës janë: djersitje, të përziera, të vjella, dhimbje stomaku dhe humbje e oreksit.

Në qoftë se keni harruar t'i jepni fëmijës Kidamol

Në qoftë se keni harruar t'i jepni fëmijës një dozë, jepini dozën pasardhëse në kohën e duhur. Mos i jepni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo.
Paracetamoli, në përgjithësi, tolerohet mirë nga organizmi.
Në raste shumë të rralla janë raportuar reaksione serioze në lëkurë.
Janë konstatuar edhe anemi hemolitike, neutropeni, leukopeni, pancitopeni, trombocitopeni, agranulocitozë, funksion jonormal i mëlçisë.
Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI KIDAMOL

Mbajeni larg fëmijëve!
Ruajeni në temperaturë më të ulët se 25°C!
Mos e përdorni Kidamol pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban pezullia orale Kidamol

Lënda aktive është paracetamoli.
5 ml pezulli orale përmbajnë 160 mg paracetamol.
Përbërësit e tjerë janë: sorbitol, propilenglikol, glicerol, celulozë dispersible, polisorbat, citrat natriumi, acid citrik monohidrat, sakarinë natriumi, metilhidroksibenzoat, propilhidroksibenzoat, esencë banane, esencë luleshtrydhe, ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit

Kuti kartoni me një shishe qelqi 120 ml.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Janar 2024.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 x 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.